

8SH-1

K 77



LETËR
nga
VURGU

VASIL
KOÇI

891.933-1

S

K 77

VASIL KOÇI

LETËR NGA VURGU

— VARGJE —

~~4773~~
13056
BIBLIOTEKA E SHITËKË
GJERGJANIT

SHTËPIA BOTONJËSE «NAIM FRASHËRI»

Tirazhi 1500 kopje Format 70 x 100/32 Stash: 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967

SHOKËVE TË MI POETË

Të flasim hapur, shokë,
pa shtrembëruar buzët,
pa bujë.

Sot

Më tepër se çdo herë tjetër
na duhen vargje,
jo të na nanuritit ne si foshnjat,
po vargje,
që socializmi t'i lidhë posi gjerdanë.

Ç'të kopjojmë kollosët e huaj?

Sot

duhet të rendim pas veprave të mëdha,
pas veprave të vendit tonë të bukur,
sepse mendimet dhe figurat janë si pemët,
secila klimën dhe tokën e vet kërkon.
Kush importon dhe në tokë të tij mbjell figura,
i thahen ato shpejt,
pa i mbjellur.

Të shkojmë, vëllezër,

tek ai punëtori që ngre pallate e fabrika,
që ngre socializmin me krahët e tij të fuqishëm.
dhe figurat tona atje t'i kërkojmë.

Tek ai fshatari
që rend fushave
dhe veshin vë të dallojë frymëmarrjen e tokës
nga frymëmarrja e vajzës së tij.
Tek ai fshatari të shkojmë;
tek ai fshatari që shkallëzon malet,
që edhe në male të ngjitet socializmi.

Dhe tok me shoferët,
Të udhëtojmë anë e kënd kësaj toke,
të udhëtojmë dhe të gëzohemi tok me shoferin
që mbart grurë, këpucë, lumturi
drejt socializmit.

Të ngjitemi majave,
atje ku qiell e male takohen miqësisht
dhe të përgjojmë atje,
pas grykës së pushkës,
lëvizjet e armiqve përtej piramidave,
dhe të dëgjojmë çdo ulërimë.
Ç'janë atje tej:
ujqër që hahen,
apo furtuna që grinden?

Sot, më tepër se kurrë, na duhen vargje,
që të gjëmojnë përpara turmave,
siç gjëmonte hapi i partizanëve tanë
që parakalonin ditën e çlirimit.

S'është poezia damë delikate,
që bredh nga një rrobaqepësi në një tjetër
për të qepur fustan mode
me basëm të jashtme,

dhe sa herë që ndërron fustanin e modës,
ndërron edhe çantën e dorës.
Çfarë mban vallë mbrenda n'atë çantë?
Një pasqyrë, dy shami hundësh, një kuti me
pudër.

Në çantën e saj poezia mban mbyllur
gjithë idealet e saj.

Poezia, shokë,
duhet të jetë bori,
dhe ne borizanë të kohës sonë.

PARA MONUMENTIT TË SKËNDERBEUT

Mbi kalin e tij,
me frenat në duar,
duke vigjiluar
pret që të ndigjojë
zërin e borisë,
zërin e Atdheut,
e të vërsulet si rrebesh
përmbi armiqtë.

TRIMËRIA JONË

Zëra, pushkë, bori dhe troke kuajsh
mbërrijnë në veshët tanë
nga thellësia e kohës.
Nëpër shekujt, vëllezër,
rend
trimëria jonë!

ATDHEU IM DHE SHEKUJT

Shekujt,
që do të vijnë n'Atdheun tim,
do të hutohen para tij
si turistët e huaj,
që vizitojnë për herë të parë
një kështjellë të papërkulur.

VERA JONË

Kjo verë e kuqe
që shikoni
në gotat tona plot —
është vera e të parëvet tanë
që pijmë ne,
Në dejet tona le të rrjedhë
trimëria e tyre.

28 NËNDORI

Përpara tribunës një maqinë parakalon.
Mbi shpinën e saj ajo Gjergjin 1) mban.
Gjëmojnë qiejt në kalimin e saj,
Tundet toka jonë.
Duartrokasin të vegjël e të mëdhenj
kur shohin të djeshmen përpara tyre të kalojë,
Duartrokasin vjetët dhe kohërat
lavdinë dhe shpirtin, që nuk vdes!

1) Gjergj Kastriotin

DE RADËS

Mbi pjestalin e tij
— i dhëmshur, i menduar.
Para tij — fëmijë të gëzuar.
Rreth e rrotull — lule shumëngjyrëshe,
Dhe përmbi kokë
— qielli,
me zogjtë e retë...

MIGJENIT

Pavdekësia të pajisi
me pasaportë të kuqe,
që të kalosh lirisht
të gjithë stacionet e shekujve.
Dhe arti të dha
vizë botërore
të nënështetësisë shqiptare.

ATA IKËN...

Ata ikën
at'herë, kur hidhte si nuse
hapin e parë
në prakun e atdheut tonë
— liria.

Ata ikën
që të vijë liria.
Dhe liria erdhi
me buqetat e ëndrrave të tyre,
si bajame e lulëzuar
në zemrën e shkurtit.

Liria
hipi në ballkonet,
doli në dritaret,
dhe me shamitë e saj të kuqe
përshtëndeti jetën,
që vërshoi në rrugët
e dehur
nga gëzimi i fitores.

Shokët tanë sot
u bënë flamuj
në ballkonet e jetës sonë.

AI RRON NË ZEMRAT TONA

Kokulur, rëndë e pa folur, kaloj në rrugë
me duart në xhepa.

Me mijëra mendime vërtiten në trurin tim
si zogj të egër anës lumenjve
në mbrëmje vonë të gushtit,
si zogj, që kthehen në folet' e tyre.

Herë, herë,

si dallgë vijnë të shkumëzuara...

Çudi! Si s'mundem që t'i mbledh
e t'i derdh në kallëpet e vargut?
Sot duhet të ngjallim të kaluarën.

Duhet të rrijmë me 'të si dy të rinj në një stol të
parkut

e t'i hapim zemrën njeri tjetrit.

Thonë se jeta është një këngë e bukur.

Por kënga jote u këput në mes një ditë,

dhe ti nuk munde ta mbarosh.

Këngën tënde at'herë,

për Jetën dhe Revolucionin,

e morëm ne dhe e bëmë flamur për lirinë,

e morëm ne dhe e bëmë hymn për luftën tonë.

Dhe ti tani mbi këngët tona fluturon nëpër Atdhe.

Thonë se jeta është një ëndërr e ëmbël,
një ëndërr e bukur.
Por ti nuk munde ta mbarosh ëndrrën tënde të
ëmbël,
që ishte ëndërr e të gjithë robërve dhe të
munduarve
se ta preu në mes një plumb,
që erdhi e të gjeti si grenzë kur ti rrije
mbi kalin tënd
dhe vështroje kufijt e botës së re,
që ndërtoje dhe ti vetë.
Por ëndrrën tënde e ngritëm ne, dhe hapëm
bulevarde të rinj të kalojnë
brezat e ardhshëm me buqetat e ëndrrave të tyre
Kush tha se Thodhoriu s'rron më?
Kush tha se Thodhoriu s'është më midis nesh?

NJERIU ME PATERICA

Në trotuar tani kalon pa këmbë.

Këmbët e tij i la diku në male.

Këmbët e tij ja fali Lirisë.

Ai tani kalon në trotuar mbi patericat e tij

si ndonjë këmbanë e gjallë njerëzore,

t'u thotë kohërave:

«Liria s'vjen vetë»!

Dhe patericat e tij trokasin nëpër pllakat,

sikur të jetë kjo jeta që troket përditë

në portën e kohës.

Në trotuar tani kalon pa këmbë.

Këmbët i la diku në male.

Këmbët e tij ja fali Lirisë.

Ai tani kalon në trotuar

i mbështetur mbi paterica.

Nesër në ditë të vështira

patericat e tij do të bëhen

në duart e tij —

në duart e atdheut tonë — shpata!

FJALË PËR DITËN E PARË PAS ÇLIRIMIT

Pushoni së vajtuari
për plagët që morëm.
S'na duhen më lot!
Na duhen këngë,
Këng'e besim,
që t'i shpërndajmë rrugëve
si trëndafilë të kuq.
Me këto armë, shokë,
do të ngrejme botën nga fillimi
dhe para së gjithash
do të ndërtojmë
zemrat tona.

48/33
13056

LIBRARI
DITËN E PARË PAS ÇLIRIMIT

POETI PARTIZAN

Mbas betejës
rrinte mbi një gur,
në majën më të lartë të kohës,
që vështronte të katër horizontet
e botës sonë socialiste,
dhe shkruante vargje.
Në pyllin e ngrirë,
atje ku edhe tymi ishte tradhëtar,
i krehte, i stoliste.
Masdite ja lexonte komisarit,
dhe ai ua ndante partizanëve
së bashku me racionin.
Vargjet e tij mbushnin zemrat e partizanëve
me besim dhe guxim,
si fishekët që mbushin pushkët
me zjarr.

VËLLAIT TË PENËS SIME

(Poetit Drago Siliqi)

Atë ditë kishim dalë
nëpër lulishtet
dhe mbliidhnim lule,
pa menduar kurrë
se lulet tona do të bëheshin
kurora,

vargje dhe lot
mbi varrin tënd.
Të prisnim që të vije...
Po ku ta dije, vëllai im
se avioni ku udhëtoje
ishte kali i vdekjes?

Të prisnim që të vije...
dhe ti do të vish përherë midis nesh,
me hapin tënd krenar,
me buzëqeshjen tënde të trëndafiltë
dhe me xhepat e tu
plot vargje dhe shpresa.

13.7.63

DIELLI DHE UNË

Së bashku me diellin
u nisëm një mëngjes,
si dy shokë të vjetër e të njohur.
Ai në mbrëmje vonë humbi në hapësirë
duke kërkuar të gjejë kufijt' e saj,
ndërsa unë humba në Vurg
duke kërkuar të gjej
kufijt' e lumturisë së tij.

VURGU

Vurgu është i gjerë si detrat.
Vurgu është i pasur si detrat.
Këtu çdo gjë është e re krejt,
dhe rrugët, dhe shtëpitë, dhe pemët,
dhe njerëzit me këngët e buzëqeshjet e tyre.
Dhe vetëm emri i tij është i lashtë,
si një leckë e zezë e prerë keq
dhe e qepur në veshjen e tij pranverore. 1)
Por vjetët e ardhëshme
do t'i venë një emër-krejt të ri,
si prindërit, që venë
emrin e një foshnje.

1) Vurg, në greqisht do të thotë «kënetë»

AI MBETI NË BISTRICË

Kur zbriti në Bisticë
nuk kishte gjë me vete,
vetëm krrabën e babait të tij
që të mbështetej aty këtu,
sikur të mbështetej ende
në botën e së djeshmes.
Dhe hodhi në Bisticë, këtu
spirancën e dëshirës së tij.
Hodhi kërrabën në lumë
dhe mori pistoletin e minatorit,
që të mund të gërmojë nëpër gurët
dhe të mbjellë mina nëpër birat e tyre,
që të mund të coptojë shkëmbenjtë
në kalimin e tij triumfal.

Një ditë-behar ahere ishte —
një gur fluturoi,
siç fluturojnë predhat në betejë,
dhe e mori në kokë,

dhe mbeti në Bistricë roje përgjithmonë.
Shokët e tij e varrosën
në hyrje të tunelit,
kurse pavdekësia i ngarkoi
detyrën e portjerit
në portën e së ardhmes.

LUTJE BASHKËFSHATARËVE TË MI

Të dashur shokë!
Atë kasolle,
që porsi plakë e matufepsur
përkulet memece,
atë kasolle, që e mbajnë
dy trarë të vegjël e të nxirë,
mos e rrëzoni, jo, përdhe!
Ajo në këmbë duhet të qëndrojë
e t'u flasë
brezave të ardhshëm
si ngrysnim jetën ne.

VARGJE PËR FSHATIN TIM

Fshati im
i harruar nga jeta,
i strukur thellë në malet,
si harabel i plagosur
me një shoshë qiell mbi kokë,
dhëmbjen e tij tymoste.
Burrat e fshatit tim
mirrnin herët udhët e kurbetit,
me një torbë në krah
të mbushur me shpresa
të gjejnë copra buke e lumturie,
që s'lindte vendi i tyre,
e një ditë t'i ndajnë
tok me familjet.
Një mëngjes pranvere
dy «stalinec» u ngjitën gjer këtu.
Flamuri i kuq që mbanin
na buzëqeshte ëmbël,
sikur na përshëndest' e nesërmja
me shaminë e kuqe.

Një mëngjes pranvere
dy «stalinec» sollën këtu
lumturinë,
si dallëndyshet që sjellin
me vete pranverën.
Fshatarët e mi,
me duar plot
dollën t'i presin,
siç kanë pritur
Shqiponjën e lirisë,
ditën
e Fitores së Madhe.
Një djalosh hipën në kurriz të tyre,
sikur hipën
në kalin e fantazisë së tij.
Një nën' e veshur me të zeza
u përkëdhel çelikut.
sikur të jetë ky
faqja e djalit t'saj të vrarë.
Dhe gjyshi Anastas në një qoshe
fërkon syt' e tij,
sikur të jetë zgjuar nga gjumi i jetës

LETËR NGA VURGU

Vjetët janë si gjyshërit.
Mbartin me vete
thasë me përralla dhe histori,
që si shofin me sytë e tyre,
ulen dhe u tregojnë
nipërve të tyre.

1.

Gjithë jetën tonë
ishim të lidhur me tokën,
siç janë të lidhura pemët me rrënjët e tyre
në dhe.
Por ne, që bënim tokën
«lule të lindë përherë»,
nuk kishim një pëllëmbë vend,
ku të ngrinim çadëren e dhimbjes sonë,
ku të hapnim varrin tonë.

2.

Beu dhe agai
 — Sfinksa të pangopur,
 rrinin mbi kokën tonë,
 dhe përditë vrisnin shpresat tona,
 dhe ndanin jetën tonë midis tyre
 si një bukë në tavolinë,
 me thikën e padrejtësisë së tyre.
 Kur vinin shirat e para
 dhe ata mblidheshin në sarajet e tyre
 me djersën tonë në xhep,
 Bistrica vërsulej në kasollet tona
 si përbindësh.

Dhe ne mbeteshim at'herë
 si kryqe të drunjta
 në mes të detit të dhimbjes sonë.

3.

Kur vinim në jetë,
 nëna na lidhte në një dërrasë,
 dhe në qafën tonë varte
 me mijëra hajmali.
 Dhe varte në to të gjitha shpresat e saj.
 Në qafën e jetës vareshin
 si zile, si këmborë
 gjithë shekujt e perënduar!

4.

Në kasollet tona të tymosura
 lumturia nuk hyri kurrë.
 Kasollet tona në mes të gjolit
 ngjisnin si vaporë
 me direkë të thyer,
 që u ankoruan aty
 në rërën e mjerimit të tyre.
 Vetëm malarja hynte e dilte në to
 lirisht,
 dhe shuante para kohe
 kandilin e jetës sonë.

5.

Vdekja-lypsare shpirtkazmë
 rrinte në prakun e shtëpisë
 dhe mblihte
 në thesin e pangopur të saj si kothere
 — kufomat tona.
 Pastaj varej në këmbanat
 — çirreshin ato nga dhimbja e tyre,
 kurse jeta
 mbliidhej kruspull në hijen e brengës së saj.

6.

Këtu tek ne çdo fshat
 kishte edhe kishën e tij.
 Në çdo kishë banonte
 dhe një «xhandar qiellor».
 Dhe përmbi' ta, si padishah
 — i plotfuqishmi.

Nga ikonat e tyre lart
na shikonin si qe,
dhe na thithnin të gjitha forcat tona,
siç thithim palcën nga një kockë.

7.

Të huajt këtu kalonin
si kuajt në vreshtë.
Disa na ngulën kokat majë hunjve
sikur t'ishim breshka,
sepse s'ndërruam besën tonë.
Të tjerë çanë barkun e grave tona
me bajonetën,
sepse mbanin «djallin» në to.
Disa na rrëmbyen bagëtitë,
të tjerë na rrëmbyen djemtë.
Të gjithë rrëmbenin lirinë.
Kishte dhe nga ata,
që ndërronin flamurin e besës së tyre
si shami hundësh,
që ja kishin shitur shpirtin e tyre edhe djallit
— siç shet qeni lirinë e tij
vetëm për një kockë.

8.

Sot në të gjithë Vurgun
Vetëm një kasolle qëndron në këmbët e saj,
E sotmja ja dha historisë
si mjet mësimor,

që t'u shpjegojë të djeshmen tonë
nxënësve të saj,
— vjetëve që do të vijnë.

9.

:

I dashuri Enver,
Kur mendojmë se dhe kënde
do të kalojë një ditë si dhëndërr i ri
komunizmi,
zemra jonë mbushet me besim
për t'ardhmen,
si ndonjë rezervuar vigan!

NË BOGAZ 1)

Çdo vit, në gusht, në këtë Bogaz
zien ahengu.
Dhe vijnë këtu vjetet e mëdha
e të pavdekshme
në atet²⁾ e lavdisë së tyre hipur.
Dhe vijnë këtu kohërat e reja
posi dhëndurë plot shkëlqim,
E pijnë, e këndojnë
të gjitha vjetet tok
dhe valle hedhin pa mbarim,
posi gjyshërit me nipërit,
posi etërit me bijtë.

1) Bogaz — vend në Vurg

2) at — kal i zgjedhur

KËNGË PËR BUKËN

1.

Biro, bukën ta respektosh gjithmonë,
ta respektosh gjithmonë, mor bir bukën,
në do të jesh dhe ti i respektuar.
Është brumosur me djersë,
është brumosur me gjak, mor bir, e uruara.

Kjo tokë,
e punuar sot me kaq afsh,
kjo tokë,
ku ti pronar i saj je vetë,
dikur ka qënë grua e huaj.
Në këtë fushë tërë ditën punonim pa pushim
të kërrusur e të heshtur,
tok me qetë
lidhur me parmendë.
Qetë ishin për ne vëllezër edhe miq.
Ne si hije vërtitëshim në fushë
me vëtulla të mvrejtura,
me buzë të qepura.

Ne në tokën tonë ishim, mor bir,
të huaj.

Ne në tokën tonë të pasur
ishim të uritur.

Kurse mbi ne fishkëllente
tok me kamxhikun e erës, kamxhiku i beut.

2.

Thellë në këtë tokë që shkelim,
stërgjyshërit tanë flenë,
dhe rrënjët tona mbajnë stërgjyshërit tanë.
Ata i braktisi të mjerë bota shpejt.
Në trastën e varfërisë së tyre lanë
një grusht dhë nga toka e tyre,
dhe grurë e misër, që ëndërronin.

Gurët e drurët në këtë fushë
janë kockat e tyre të patretura,
janë kockat e tyre,
që ranë në parmendë me qetë, mor bir.

E madhe ishte dhëmbja e tyre,
tokë e lëruar zëmr' e tyre e dhëmsur
mbi të cilën fluturonin zogj të lirë.
Jeta për ta, o bir, ishte gur varri e rëndë,
dhe njëmijë herë m'e rëndë — robëria.

3.

Në këtë arë të blertë buzë lumit
një bujk kaloi buzëmbremjes
dhe theu një kalli.

Fëmijë të uritur e prisnin në shtëpi,
Dhe duhej harruar uria e mallkuar.
Duhej harruar, qoftë dhe për një natë.

(Dhera të mallkuara ishin këto dhera,
dhe ishin vjetët, more bir, atëherë,
arna
të qepura keq në trupin tonë...)

Bujku i varfër
gjithmonë rebel kish qenë me bejlerët,
dhe gjithmonë veç të zeza kish hequr.

Duke u kthyer në kasolle vetëm,
në mbrëmjen e mërziisë së vet
dhe të urisë së fëmijëve,
e zunë rojet,
e lidhën xhandarët
dhe e prunë rebelin para beut.
Nuk kish paguar taksat kaqë vjetë,
dhe pëshpëriste, kasolleve pëshpëriste.

Në agim të ditës tjetër gjithë çifligu
shikoi si varej bujku i varfër,
shikoi si lëkundej bujku trim,
i varur te rrapi, në mes të fshatit.

Bujku lëkundej papushim në erë,
ndërsa kalliri kishte rënë në tokë
si bombë,
dhe njëqind herë më e rëndë se bombë.

Ç'të shihje, djalë!
Nga pyjet, àrat, kasollet dilnin njerëzit
me drunj, me cfurqe, me drapinj.
dhe drejt kullës së beut suleshin...

A mund të duronin t'ua vrisnin shokun,
shokun që u jepte dritë nëpër natë,
të cilin fëmijët e prisnin të uritur?

4.

Bukën, mor bir, duhet ta respektojmë,
duhet ta respektojmë gjithmonë bukën...
Kur trokitnin në portat tona vitet e luftës,
vitet e rënda e të ashpra të luftës,
ne me partizanët kasolleve ndanim
gëzimet tona dhe bukën e paktë.
Buka, mor bir, kish gjakun tonë të pakursyer,
dhe djersën tonë buka kish.

Edhe kur na mungoi ajo në sofër,
besimi kurrë s'na mungoi, bir.
Kur zbrisnin partizanët nga malet e larta
dhe flisnin për fitoret,
si për korrje të begata,
na ngopnin lajmet e gëzuara gjithmonë.

Do të bëheshin tonat fushat,
do të bëheshin tanët malet,
do të bëheshin pyjet, lumenjtë, tanët
dhe buka jona do të bëhej, mor trim.

5.

Dhe erdhi koha, qetë t'i zgjidhim nga parmënda
dhe dalngadalë
nga fushat në malet e lartë të ngjitemi,
se s'ngjiten, biro, atje lart traktorët dot!

Dhe erdhi koha që çdo pëllëmbë të kësaj toke
t'i kërkojmë atë, që shekuj mbante fshehur,
dhe priste që t'ja gjenim ne.

Maleve, ku shqiponja mpreh sqepin,
Ka diell të përjetshëm, ka dhe bukë.
Ka lumturi maleve, ku trokasin kazmat,
e kur hambari është plot, o trimi im,
e në trastën tënde mban plot fishekë.

6.

T'i falemi kësaj toke të begatë,
T'i falemi këtij dielli të përjetshëm, bir,
Ne jemi vetë zotët e kësaj toke,
Fushat e malet para syve tanë kalojnë
Si kafshë të ngarkuara rëndë nëpër muzg.
Dhe ne të gjithë,
Të mëdhenj e të vegjël,
Në atdheun tonë të lirë,
Hymnin e bukës e të lumturisë këndojmë.

DY ANË TË KUNDËRTA

Në Kongo,
vanë kaqë vjetë,
që ushtërit' e Kombeve të Bashkuara,
(e Shteteve të Bashkuara dua të them)
vrasin si zogj
ëndrrat e kontinentit të zi.

Në Vietnam,
jankitë dhe aleatët e tyre
pushkatojnë
njëmijë herë në orë
lirinë e gjithë botës.

Në Republikën Domenikane,
që monopolet amerikane
e konsiderojnë kafshatë në tavolinën e tyre,
Demokracinë
si shqerrë e therin.

Kurse revizionistët
nuk pushojnë të shpërndajnë nëpër botë,
si retë e mbarsura, që shpërndajnë
në atmosferë
pluhurin e tyre radioaktiv,
parimet e famshme
të «bashkëekzistencës paqësore».

HEROI DHE XHELATËT

(*Ngujen van Troit*)

Të zunë, o vëllai im,
kur ti shkoje të takoje
bashkë me njëzet e katër pranverat e tua,
lirinë e Atdheut tënd,
i patrëmbur, i qeshur,
si një i ri që shkon
të takojë të dashurën e tij
me një buqetë lulësh.

Dhe një mëngjes të çuan
para vdekjes,
por, në çastin kur hipje në trekëmbësh
ti hipje në tempullin e lavdis' sate,
dhe që andej
u fole vrasësve të tu.
Fjalët e tua ishin
plumba të skuqur në zemrën e tyre:

«Atdheu im
kurrë s'do të vdesël»

Nesër,
nën këtë trekëmbësh
— nën këtë hark të triumfit —
do të kalojë Atdheu yt i lavdishëm
me vajzën e tij të vetme,
me Lirinë.

NJE NËNË VJETNAMEZE MBI VARRIN E
DJALIT TË SAJ

Më fal, o bir,
që nuk të solla dot dy lule,
asgjekundi s'munda të gjej
dy gjethe të jeshilta.
Mbi varrin tënd nuk qëndroj
me duar të kryqëzuara porsi mumje;
erdha të ndreq dheun e tij,
si at'herë kur ishe i vogël
dhe të ndreqja, të mos ftoheshe
mbulesat e krevatit.
Lotët që duken
në cep të syve
s'janë gjë,
kështu e kemi ne, o bir, nënat,
mallëngjehemi
kur përcjellim djemtë tanë
në udhëtim të largët.
Erdha të marr, o biri im,
besimin dhe vendosmërinë,
urrejtjen tënde,
që të ndjek skllavërinë.

PËRGJIGJE

Me aeroplanët tuaj
u derdhët si shigjeta legjionesh
që të rrëzoni diellin e Atdheut tonë,
dhe në vend të tij të gozhdoni
llambadhen e fjetur të lirisë suaj perëndimore.

Dhe erdhët
si thasë të ngarkuar
në vaporët dhe kryqëzorët tuaj,
që të na ngarkoni për plantacionet e Alabamës,
për xhunglat e Brazilit,
për minierat e errëta të Kilit,
për portet zhurmëmëdhenj të Kalifornisë.

Dhe erdhët
të mbyllur në tanket dhe në autobлиндat tuaj
që të mos ju gjejë vdekja jonë.
Dhe i lëshuat ato
si gjarpërinj gjuajtës
të mbysin jetën tonë, që s'u gjunjëzua kurrë!

Por këtu në çdo hap tuajin
takuat urrejtjen tonë,
gjetët grushtat tonë të ngritur lart,
që vitet e fundit u rritën shumë,
më shumë edhe nga pemët tona,
duke bërë kështu
pyllin më të madh njerëzor para jush

Prandaj avionet tuaj
bien si sorra të ngordhura nga qielli ynë.
Tanket dhe autobлиндat tuaj
mbeten të shpërndarë andej-këndeje
si kafka breshkash,
që t'i shkelmojnë
vjetet e ardhshme.
Kurse vaporët dhe kryqëzorët tuaj,
që u ankoruan në brigjet tona
si përbindështa,
çdo çast ngarkojnë kufomat tuaja,
si nekrofore. 1)

1) Nekrofora = karroca që shpie të vdekurit në vorrezat.

LETËR BORISIT, VËLLAIT TIM TË MADH

Vanë kaq vjetë, Boris,
që heshtja po më bren,
por tani durimi im mbaroi,
prandaj vendosa të të shkruaj,
siç mund t'i shkruaj vëllait tim të madh.
Ku ndodhesh vallë tani?
Në Leningrad, në Moskë, a në Vladivostok?
Adresën nuk ta dij me saktësi,
prandaj mbi zarfin tënd shkruaj:
Borisit,
kudo që ndodhet, në Rusi...

Vanin, vëllain tonë më të vogël
e varën bashkë me njëzet e katër pranverat e tij
një mëngjes të bukur vjeshte
në qendrën e Sajgonit.
Dhe a e di pse?
Sepse urrente dimrin e robërisë,
dhe nuk mund të shihte të huajt
të shkelin
si kuaj mbi varret e stërgjyshërve të tyre.
Sepse kishte hipur

në majë të një shtylle të lartë elektrike,
— në direkun më të lartë të lavdisë së kohës
sonë —

dhe zbukuronte rrugët e atdheut të tij
me llamba shumëngjyrëshe,
me idet' e komunizmit,
që të kalojë liria.

Gjyshin e tij, Boris,
e kishin pushkatuar francezët
at' here kur hynë në fshat për herë të parë,
se nuk ju fal si rob.
Baban' e tij e vranë japonezët,
Sepse trupin e tij s'e bëri
gur që ta shkelnin.
Kurse Vanin tonë
e varën kanibalët amerikanë.
Të gjithë okupatorët Boris,
kanë të njëjtën fytyrë e sjellje,
dhe le të mos kenë të njëjtin emër e të njëjtën
gjuhë:...

Para se ta varnin,
një prift ju afrua me gotën e shenjtë në dorë.
Hipokrizia —

e veshur me rrobat e perëndisë
nuk mundi të thyejë shpirtin e tij,
sepse mbaheshin fort në tokë pjellore
rrënjët e tij.

Dhe kur xhelatët i zunë sytë
me një shami të zezë,
ai e coptoi përpara tyre,
sikur të coptonte në sytë e gjithë botës
vdekjen çelik-veshur.

Dhe kur i shkelmuan stolin,
Vani ynë mbeti i varur në erë
si ndonjë kambanë gojëmadhe
në kambonaren më të lartë të kohës sonë,
që lajmëron fundin e palavdishëm të jankive.

Dhe ti, Boris, nuk di gjë!?

2.

Pardje Boris,
aeroplanët bombardues amerikanë,
që fluturojnë kope-kope
si zogj të vdekjes,
që gjëmojnë si demonë nga urrejtja e tyre,
vranë dhe shtatë vjeçarin Li ho,
në kohën
kur me shaminë e kuqe në qafë,
me një buqetë lulësh shumëngjyrëshe
për mësuesen e tij,
dhe me çantën e tij nën sqetull
hidhte hapin e parë në jetë.
Ishte i gëzuar vogëlushi Li ho,
si një dallëndyshe,
që sapo nxori krahë,
si një luledielli,
që sapo filloi të përshëndesë ditën.

Bomba që plasi afër tij
dhe i hapi në kokë një plagë,
që ngjante më tepër me lulekuqe sesa me plagë,
dhe i preu në mes rrugën,

vrau gëzimin fëminor të të gjithë botës.
Lulet që mbante në dorë
akoma edhe i vdekur, —
ishin ëndrrat fëminore të gjithë botës,
që i vranë bombarduesit amerikanë
atje, në Vietnamin e Veriut.
Dhe ti, Boris, nuk di gjë!?
Çudi, si nuk dëgjon bombat që bien në fqinjën
tënde,
në çast kur dëgjohe në Teksas,
akoma edhe në Washington?
Ato bomba nesër mund të bien në tokën tënde
dhe të çvarrosin të gjithë stërgjyshërit tuaj,
mund të bien mbi çatinë e shtëpisë sate
dhe të rrëzojnë të gjithë jetën tënde.

3.

Në mars, vjet, Boris,
(shkrojtën dhe fletushkat tuaja,
që deshën të mbysin të vërtetën, si shtriga,
në fyt)
studentët nga të pesë kontinentet
u derdhën si lavë e kuqe në Moskë.
Kur kaluan përpara ambasadës amerikane,
ngritën grushtat e tyre.
Të pesë kontinentet u bënë një grusht përpara
rrezikut
Shishet e bojës u bënë bomba në duart e tyre,
kurse boja që leu fasadën e ambasadës,
qe urrejtja që vërshoi nga shpirti i tyre i
indinjuar.

Por ç'të shihje at'herë, Boris!
Kundra studentëve u vërsulën shtatëqind
kavaleristë

të mbysnin zërin e pesë kontinenteve,
të rrëzonin grushtat e tyre si kallinj
dhe të shkelnin trupat e tyre.
Dhe ne pandehëm, Boris,
se u ringjallën caristët e njëmijë e nëndëqind e
pesës.

se u derdhën në rrugët e Ruisë prapë
bjellogardistët e Denikinit dhe Kollçakut,
dhe le të ishin ata, policët sovjetikë.

Midis studentëve
ndodhej dhe vëllai ynë më i madh, Lu Sin.
Kur e panë policët tuaj u tërbuan,
dhe derdhën mbi 'të gjithë shtazërin' e tyre.
Sikur të mos mjaftonte kjo,
kur të pesë kontinentet e ngritën në duart e
tyre,
sikur të ngrinin nderin dhe lavdinë e shekullit
tonë,

dhe e çuan në një nga spitalet tuaj,
ata i mbyllën derën.
Kurse udhëheqësit tuaj
në të njëjtën ditë u përkulën si gjynahqarë
përpara afendikonjve — amerikanëve,
dhe dërguan të shuajnë nga faqja e ambasadës
njollat e bojës,
por kurrë s'do të mundin të shuajnë turpin e tyre,
Boris,
nga faqja e historisë.

4.

Vanë kaq vjet, Boris,
 që lufta sillet si bushtër e tërbuar në Lindje
 dhe herë kafshon një shtet
 herë një tjetër,
 siç e urdhërojnë të zotët e saj.
 Por vanë gjashtë vjet tani,
 që Vietnami i numron brinjët.
 Gjashtë vjet që Vietnami mbytet në gjak,
 kurse udhëheqësit tuaj,
 gjashtë vjet tani, që u bënë krushq me
 imperialistët amerikanë.

dhe pijnë e dëfrejnë,
 duke ja shkelur plot kuptim syrin njeri tjetrit.
 Uiski dhe konjaku, që rrjedh në gotat e tyre,
 dhe derdhet në buzët e tyre,
 është gjaku i të munduarve të Tokës sonë,
 që kishin varur shpresat e tyre tek ata;
 është gjaku që derdh populli vietnamez,
 që mban në shpatullat e tij peshën e shekullit
 tonë,
 që me heroizmin e tij
 rrëzon si shtëpi prej letre të gjitha prapaskenat
 tradhëtare

Dhe ti, Boris, nuk di gjë
 për Moskën, që u çmënd duke vallzuar
 nën ritmin e xhazeve amerikanë?!

Boris, a ke shkuar ndonjëherë në mauzoleumin
 e Leninit?

E ke pyetur, o vëllai im, ç'mendim ka Ai
për të gjitha këto gjëra? Si i sheh Ai?
Vjetët e fundit, Boris,
u zbe shumë Lenini

në atdheun tuaj,
në kohën kur mendimi i tij
shetit në rrugët e botës.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Shokëve të mi poetë	3
Para monumentit të Skënderbeut	6
Trimëria jonë	7
Atdheu im dhe shekujt	8
Vera jonë	9
28 Nëndori	10
De Radës	11
Migjenit	12
Ata ikën	13
Ay rron në zemrat tona	14
Njeriu me paterica	16
Fjalë për ditën e parë pas çlirimit	17
Poeti partizan	18
Vëllait të penës sime	19
Dielli dhe unë	20
Vurgu	21
Ai mbeti në Bistricë	22
Lutje bashkëfshatarëve të mi	24
Vargje për fshatin tim	25
Letër nga Vurgu	27
Në Bogaz	32
Këngë për bukën	33
Dy anë të kundërta	38
Heroi dhe xhelatët	40
Një nënë vietnameze mbi varrin e djalit të saj	42
Përgjigje	43
Letër Borisit, vëllait tim të madh	45